

Lënda:MAKROEKONOMIA

Kreu: I;II;III;IV

Universiteti i Novi Sad-it, Fakulteti Ekonomik Bujanoc

Bartësi i lëndës: Prof.dr. Merale Fetahi-Vehapi
Ass. Doc.dr. Elsana Aqifi

Adresa elektronike:

merale.fetahi@unite.edu.mk

Elsana.afiqi@unite.edu.mk



Objektivi i lëndës

- ▶ Arritjen drejt njohjes dhe zhvillimit të menduarit kritik mbi zbatimin, aplikimin dhe analizimin e koncepteve fundamentale ekonomike,
- ▶ Fitimi i njohurive baze mbi konceptet makroekonomike në përgjithësi, dhe në veçanti kuptimi i funksionimit të ekonomisë nacionale dhe politikës ekonomike të zbatuar.

dhe gjithashtu

- ▶ Përgatitja e studentit në të menduarin logjik, mbi lëvizjet e fenomeneve ekonomike në jetën e përditshme dhe situatat hipotetike



Pritjet nga lënda

- ▶ Absorbim i njohurive të mjaftueshme mbi konceptet, nocionet dhe teoritë kryesore makroekonomike
- ▶ Përcjellja, funksionimi dhe matja e parametrave kryesore makroekonomike
- ▶ Analizimi dhe nxjerrja e konkluzioneve mbi fenomenet makroekonomike
- ▶ Aftësimi drejte avancimit të mëtejshëm...



Literatura

- ▶ **Makroekonomia** (Parimet, Teoritë, Politikat) – **Kosta Josifidis** 2011, Beograd
- ▶ **Makroekonomi, Petrit Pollozhani -2015, Tetovë**
- ▶ ***Ekonomiksi Makroekonomia***-N.Gregory Mankiw dhe Mark P.Taylor (perkthim Tirane UET/Press-2012)
- ▶ ***Macroeconomics*** – Olivier Blanchard
- ▶ **Leksione te Makroekonomise** – te zgjedhur nga ligjeruesi



Pjesa përmbajtësore të materialit:

- ▶ Kuptimi (natyra) dhe metodologjia e Ekonomisë
- ▶ Kuptimi (natyra) dhe vështrimi i Makroekonomisë
- ▶ Doktrinat(shkollat) në Makroekonomi
- ▶ Matja e aktiviteteve Ekonomike
- ▶ Makroekonomia në afat të shkurtë
- ▶ Modelet e ofertës agregate
- ▶ Paraja dhe Banka Qendrore
- ▶ Tregu i mallrave dhe tregu i parasë
- ▶ Tregu i punës dhe papunësia
- ▶ Politika Fiskale
- ▶ Paraja,Monetarizmi, çmimet, pritjet
- ▶ Makroekonomia e ekonomisë së hapur
- ▶ Rritja Ekonomike



Kapituli i I-rë

pyetjet kërkimore?

- ▶ Ç'është ekonomia?
- ▶ Pse mësohet ekonomia?
- ▶ Çka studion ekonomia si disipline shkencore?
- ▶ Ne cilin grup te shkencave, bëjnë pjesë shkencat ekonomike?
- ▶ Çka i bene te dallueshme nga shkencat tjera shoqërore?
- ▶ Perse duhet ju si student, t'i viheni studimit te shkencës ekonomike?
- ▶ Mikroekonomia knd. Makroekomisë ?
- ▶ Metodologjia e studimit ?



Shkenca e ekonomisë është një studim i njerëzimit në sipërmarrjen e zakonshme të jetës.

Alfred Marshall

(Parimet e shkencës ekonomike)

Arsyeja pse duhet studiuar shkencat ekonomike në përgjithësi dhe makroekonomia në veçanti?

- **Arsyeja e parë** –do të ju ndihmoj të kuptoni botën në të cilën jetoni?
- **Arsyeja e dytë** - do të ju aftësoj që të jeni një pjesëmarrës më finok në ekonomi.
- **Arsyeja e tretë**- të kuptoni potencialin dhe kufijtë e politikës ekonomike.



- ▶ Shkencat ekonomike bene pjese ne **grupin e shkencave shoqëror.**

- ▶ Shkencat ekonomike për dallim nga shkencat tjera shoqërorë, lende studimi kane **marrëdhëniet shoqërore ne sferën e prodhimit material.**
- ▶ **Ekonomia është shkencë që studion sjelljen e njerëzve si raport ndërmjet qëllimeve dhe mungesës së mjeteve të përshtatshme për përdorime alternative.**
- ▶ Ekonomia ka për objekt studimi dukuritë, proceset dhe ligjet objektive qe kushtëzojnë dhe rregullon marrëdhëniet midis njerëzve ne procesin e prodhimit shoqërorë: **prodhim, shpërndarje, këmbim dhe konsum.**
- ▶ Kriteret e vlerësimit mbi bazën e te cilave studiohen sistemet ekonomike orientohen sipas dy këndvështrimeve te ndryshme nga te cilat marrin nisem dy sektorë te shkencës ekonomike qe marinë emrin e “**Makroekonomisë**” dhe te “**Mikroekonomisë**”.
- ▶ Mikroekonomia ekzaminon sjelljet e subjekteve te veçanta ekonomike
- ▶ Diferenca qe ekziston ndërmjet mikroekonomisë dhe makroekonomisë mbështetët ne objektin e studimit dhe mënyrën e trajtimit. !!!



Çka e dallon mikroekonominë nga makroekonomi?



Objekti i studimit?

- ▶ Makroekonomia merret me **ecurinë e sistemit ekonomik** ne tërësi, me fazat e **ekspansionit** dhe **recesionit** te prodhimit total te mirave materiale dhe shërbimeve, me rritjen e prodhimit, nivelin te **inflacionit** dhe **papunësisë**, ne nivelin e shkëmbimeve si dhe me karakteristikat themelore te **ndërveprimit** ndërmjet **tregut te produkteve, te punës** dhe **aktiviteteve financiare** te sistemit ekonomik.
-



Cilët janë aktorët kryesorë të sistemit ekonomik?



Governments



Central Bank

Financial System



Businesses /
Firms /
Corporates




Households/
Citizens


COUNTRY A



Lidhja bashkëvepruese në mes aktorëve!



Pasqyrimi i plotë i objektivit studimorë:



- Në përdiçmëri ka numër të pafund pyetjesh që na interesojnë!
p.sh. përse standardi jetësor i vendeve afrikane është shumë i ulët dhe ai i Evropës Perëndimore është shumë i lartë? Përse disa shtete kanë inflacion të lartë e disa të ulët? Përse disa vende anëtare të BE-së kanë pranuar euron si monedhë të përbashkët dhe disa ruajnë monedhat e veta kombëtare? Përse disa shtete fitojnë më shumë në këmbimin ndërkombëtar të mallrave dhe shërbimeve e disa më pak? Përse shfaqen krizat ekonomike? Si mund të fitojmë nga paratë e kursyera? Janë disa nga pyetjet për të cilat makroekonomia mund t'ju ndihmojë të përgjigjeni.
- Dukuritë makroekonomike i hasim në jetën e përditshme., **!!!** Prandaj edhe Makroekonomia na ndihmon për të marrim vendime racionale, në përdiçmëri, duke u nisur nga fakti që në jetën e përdiçme secilli nga ne merr vendime ekonomike!
- *Studimi i makroekonomisë në shekullin XXI, kur ekonomia botërore funksionon gati si një ekonomi kombëtare do të thotë të njohësh botën në të cilën jeton.*




- **Objektivi i makroekonomisë** është të shpjegoj ndryshimet ekonomike që mund të ndikojnë njëkohësisht mbi shumë familje, firma dhe tregje.

Indikatorët kryesore Makroekonomik

- Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB-GDP)
- Punësimi
- Papunësia
- Inflacioni
- Këmbimi ndërkombëtar
- Kurset e këmbimit
- Buxheti i shtetit
- Paraja
- Normat e interesit
- Recesioni
- Depresioni
- Rritja ekonomike
- Investimet
- Kursimet...




- **Aspekti kohor i analizave makroekonomike është dydimensional: afatgjatë dhe afatshkurtër.**

 - ***Në periudhën afatgjatë ekonomia ka tendencë rritjeje dhe*** PBB aktual barazohet me PBB potencial dhe ekonomia punon në nivelin e punëzënies së plotë.
 - ***Në periudhën afatshkurtër studiohen lëvizjet ciklike të ekonomisë.***
-
- 

Aspekti kohor i analizave makroekonomike

Rritja ekonomike



I. ZANAFILLA E MAKROEKONOMISË

- ▶ **Fenomenet makroekonomike** u takojnë periudhave shumë më të hershme kohore, mirpo, makroekonomia si shkencë u paraqit në shekullin XIX.
 - ▶ Themelues i saj është ekonomistit i famshëm anglez **Xhon Majnard Kejnsi (John Maynard Keynes)**, i cili në vitin 1936 botoi librin e tij të famshëm ***Teoria e përgjithshme e punësimit, kamatës dhe parasë, dhe vendosi themelet e makroekonomisë.***
 - ▶ **Mendimi ekonomik klasik dominon nga fundi i shekullit XVII, dhe lidhet me emrin e Adam Smitit (themeluesin e ekonomisë politike klasike angleze).** Ai u bë i famshëm me botimin e librit *Pasuria e kombeve, në vitin 1776.* Sipas Smitit rrjedhat ekonomike rregullohen nga mekanizmi i tregut ose siç e quan ai **dora e padukshme.** Mekanizmi i çmimeve (dora e padukshme) koordinon planet dhe sjelljet individuale dhe mundëson alokimin efikas të resurseve.
-



- ***Xhon Majnard Kejnsi*** u paraqit me mendimin se ekonomia e tregut kapitalist është jo stabile dhe krijon kriza. ***Arsyeja kryesore e paqëndrueshmërisë ekonomike, sipas Kejnsit, janë luhatjet ciklike të kërkesës agregate. Në veprën e tij të famshme "Teoria e përgjithshme e punëzënies, interesit dhe parasë" (1936), ai argumentoi rolin e shtetit në rrjedhat ekonomike.***
- Depresionin e madh ekonomik (1929-33), në SHBA e karakterizon rritja e nivelit të papunësisë, tkurrja e konsumit personal, investimeve, normës së interesit, dhe ulja e nivelit të çmimeve
- Ekonomisti i famshëm anglez ***Xhon Majnard Kejnsi ishte i pari që propozoi masa konkrete për dalje nga kriza. Përkundër klasikëve ai kërkon intervenimin masiv të shtetit në ekonomi, Kejnsi llogaritet si themeluesi i makroekonomisë.***



Ndryshimet e PBB dhe prodhimit industrial në periudhën e depresionit të thellë ekonomik 1929-33

Shtetet	PBB	Prodhimi industrial	Shtetet	PBB	Prodhimi industrial
Austria	- 22.5	-34.3	Spanja	- 8.0	- 11.8
Belgjika	- 7.1	-27.1	Suedia	- 8.9	- 11.8
Danimarka	4.0	- 5.6	Anglia	- 5.8	- 11.4
Finlanda	- 5.9	- 20.0	SHBA	- 28.0	- 44.7
Franca	- 11.0	- 25.6	Çekosllov.	- 18.2	- 26.8
Gjermania	- 15.7	- 40.8	Hungaria	- 11.5	- 19.2
Italia	6.1	- 22.7	Polonia	-	- 37.0
Holanda	8.2	- 9.8	Rumania	-	- 11.8
Norvegjia	- 0.9	- 7.9	-	-	-

Burimi: Kosta Josifidis, 2010, *Makroekonomija*, Grapfic, Novi Sad, fq. 83



Ecuria e indikatorëve makroekonomik në depresionin e thellë (1929-33), në SHBA, (në miliard \$)

	1929	1930	1931	1932	1933
Norma e papunësisë	3.2	8.9	16.3	24.1	35.2
PBB real	203.6	183.5	169.5	144.2	141.5
Konsumi i amvisërive	139.5	130.4	128.1	114.8	112.8
Investimet	40.4	27.4	16.8	4.7	5.3
Shpenzimet qeveritare	22.0	24.3	28.4	24.2	23.3
Norma e interesit	5.9	3.6	2.6	2.7	1.7
Oferta e parasë	26.6	25.8	24.1	21.1	19.9
Inflacioni	-	- 2.8	- 10.1	- 9.3	- 2.2
Parat kesh	52.6	52.3	54.5	52.3	50.7

Burimi: G. Mankiw, *Macroeconomics*, 4 rth edition, Worth Publishers, 2000, fq. 296 – 297,

SHKOLLAT E MENDIMIT EKONOMIK

I. Shkolla Kejnsiane

- ▶ *Kejnsi argumentoi mundësitë ekuilibruese ekonomike në kushtet e një mospërdorimi masiv të burimeve.*

II. Neoklasiket

- ▶ shkolla e ofertës, është aftësia e vetë-ekuilibrit të tregjeve. Sipas tyre, individët veprojnë në mënyrë racionale sipas interesit të tyre dhe ato u përshtaten me shpejtësi kushteve të tregut

III. Neokejnsianët

vlerësojnë se tregjet nuk pastrohen edhe kur bizneset ose punëtorët përkujdesen për interesat e tyre, sepse u mungojnë informacionet.



Prandaj, shtrojmë pyetjet?

- ▶ Cili është qëllimi i çdo ekonomie?
- ▶ Nga çka varet zhvillimi ekonomik i vendit?
- ▶ Cilët janë qëllimet dhe instrumentet e makroekonomisë?
- ▶ Me çka shprehet efikasiteti i makroekonomisë?



Qëllimi i çdo ekonomie:
Zhvillimi i forcave prodhuese

Zhvillimi ekonomik varet nga politika e zbatuar
makroekonomike

Efikasiteti i politikës makroekonomike shprehet
nëpërmjet madhësive të treguesve global ekonomike



Cilët janë qëllimet (objektivat) e makroekonomisë?

Makroekonomia si lëmi e ekonomisë në politiken e vetë synon të realizoj objektivat të cilat do të ndikojnë në ngritjen e mirëqenies së popullsisë

- **Sigurimi i normave të qëndrueshme zhvillimore** matet me /DPBB/
- **Prodhimi** (rritja e qëndrueshme)
- **Punësimi** (hapja e vendeve të reja të punës)
- **Stabilizimi i çmimeve**
- **Bashkëpunimi ndërkombëtar**



- ▶ **Rritja e qëndrueshme e ekonomisë - nënkupton rritjen e të mirave dhe shërbimeve (Prodhimi i Brendshëm Bruto) në periudha të gjata kohore.**
 - ▶ Dallojmë 2 teori të rritjes ekonomike, ato janë:
 - **Teoria e rritjes në periudhë afatgjatë;**
 - **Teoria e rritjes në periudhë afatshkurtër**
 - ▶ Ekonomistët vlerësojnë se një ekonomi e cila realizon norma vjetore rritjeje prej 5 %, të mirat dhe shërbimet e saj do t'i dyfishojë për 14 vite, dhe ekonomitë të cilat realizojnë rritje mesatare vjetore prej 1 %, të mirat dhe shërbimet do t'i dyfishohen për 70 vite.
-



Norma e inflacionit në disa shtete të botës në vitin 2014

Shtetet	Norma e inflacionit	Shtetet	Norma e inflacionit
Hungaria	0.10	Gjermania	0.85
Norvegjia	2.20	Greqia	- 0.70
Luksemburgu	1.00	Kosova	0.80
Rusia	13.1	Shqipria	1.80
Spanja	- 0.70	SHBA	2.00
Slovenia	- 0.10	Kina	2.30
Suedia	- 0.20	Belgjika	0.97
Zvicra	0.00	Kroacia	0.37
Italia	0.09	Sudani	38.02
Britania Madhe	0.00	Bellorusia	19.58
Japonia	3.60	Gana	15.7
Finlanda	0.80	Ukraina	11.45
Franca	0.50	Egjypti	10.00

Produktiviteti i punës për vitin 2013 sipas paritetit të fuqis blerëse në disa shtete selektive

Shtetet	Produktiviteti	Rangimi	Shtetet	Produktiviteti	Rangimi
Norvegjia	75.18	1	Austria	54.83	13
Luksemb.	73.22	2	Anglia	51.38	14
SHBA	67.32	3	Islanda	50.01	15
Bellgjika	60.98	4	Zvicra	49.68	16
Hollanda	60.06	5	Spanja	44.59	17
Franaca	59.24	6	Finlanda	48.76	18
Gjermania	57.36	7	Peru	10.99	56
Irlanda	56.05	8	Brazili	10.78	57
Australia	55.87	9	Armenia	10.00	58
Danimarka	55.75	10	Tajlanda	8.64	59
Suedia	55.28	12	Sri Lanka	6.85	60

Cilët janë instrumentet e makroekonomisë?

Instrumentet janë mjetet me të cilat realizohen objektivat e politikave makroekonomike.

- A. **Politika monetare**
- B. **Politika fiskale**
- C. **Politika e të ardhurave**
- D. **Instrumentet e politikës së tregtisë së jashtme**



- ▶ Aktivitete ekonomike luhaten nga viti ne vite. Ne shumicën e viteve, prodhimi i mallrave dhe i shërbimeve rritet nga vete fakti qe rritet krahu i punës, rritja e fondeve te kapitalit dhe përparim ne njohuritë teknologjike , e kjo mundëson një standard më të lartë të jetesës.
- ▶ Si zakonisht rritja matet me PBB-real.
- ▶ Nëse ekonomia prodhon me pak mallra dhe shërbime, PBB-ja reale tregon rrënje, te ardhurat ulen, papunësia rritet dhe treguesit e tjerë te te ardhurave bien, Atëherë, ky proces në ekonomi quhet **RECESION** (nëse është relativisht) i bute dhe **DEPRESION** (ne qofte se është me i ashpër).
- ▶ Horizonti kohore!
- ▶ Shumica e ekonomisteve përdorin kërkesën dhe ofertën agregate, për te analizuar luhatjet afatshkurta.
- ▶ Modelet e AD;AS dhe EE



Çka i karakterizon luhatjet ekonomike:

1. Luhatjet ekonomike janë te parregullta dhe te paparashikueshme
2. Shumica e treguesve makroekonomik luhaten se bashku
3. Me rënien e prodhimit, papunësia rritet.

Diskutim dhe dhënie e mendimit!



II. KËRKESA AGREGATE (AD) DHE OFERTA AGREGATE (AS)

- ▶ Në mikroekonomi është prezantuar kërkesa individuale dhe kemi theksuar se ajo paraqet sasi të mirave dhe shërbimeve të cilat blerësit janë të gatshëm dhe mund t'i blejnë. Siç e dimë, kurba e kërkesës individuale ka pjerrtësi rënëse, sepse tregon raportin invers midis çmimit dhe sasisë.
- ▶ Kur çmimi ishte faktor i vetëm, lidhjet inverse, sasi - çmim, krijoheshin në një kurbë, dhe kur në kërkesë ndikojnë dhe faktorët e tjerë kurba zhvendosej djathtas (rritje) ose majtas (zvogëlohej) pozicionit të saj fillestar.




Çka ne fakt paraqet AD (Kërkesa Agregate)?

- ▶ Kërkesa agregate paraqet shumën e të gjitha kërkesave individuale.
- ▶ Sasia e tërësishme e të mirave dhe shërbimeve në një ekonomi kombëtare (PBB aktual), në të cilën sektorët e ndryshëm të ekonomisë janë të gatshëm ti blejnë për çfarëdo niveli të çmimeve.
- ▶ Kur çmimi është faktor i vetëm, **lidhja inverse**, sasi-çmim, krijoheshte në një kurbe.
- ▶ Sasi e kërkuar KND. Kërkeses si tërësi.



Grafiku 1

Kurba e kërkesës agregate (AD)




► Kerkesa agregate sipas modelit Kejnsian

$$AD=C+I$$


Te nxitet konsumi personal dhe te stimulohen investimet – ne recesion.

Klasikët: kurba e ofertës agregate ne kushtet e fleksibilitetit të plote te çmimeve dhe mëditjeve te punëtorëve është ne pozitevertikale.



-
- ▶ Ne periudhen afatshkurter, zhvendosjet e kerkeses agregate shkaktone luhatje ne prodhimin nga ekonomia e mallrave dhe sherbimeve
 - ▶ Ne periudhen afatgjate, zhvendosjet e kerkeses agregate ndikojne mbi nivelin e pergjitheshem te cmimeve por nuk ndikojne mbi prodhimin.
-
- 

Rëndësia e kurbës së kërkesës sipas modelit Kejnsian



Faktorët të cilët ndikojnë në kërkesën agregate

▶ **$AD = C + I + G + Nx$.**

▶ ***Sektori i amvisërive (C – consumption)***

konsumon lloje të ndryshme të të mirave dhe shërbimeve, (ushqime, shërbime të ndryshme, veshmbathje, kompjuterë, celularë, televizorë, mobile, makina për amvisëri, etj.)

▶ ***Vendimet për nivelin e Investimeve (I - Investment)***

Rritja e investimeve (teknologji të reja, objekte administrative, fabrika etj.)

▶ ***Niveli i konsumit publik i projektuar nga qeveria (G Government)***


▶ ***Ndryshimet në neto eksport (Nx – Net exports)***




Grafiku 2

Ndikimi i normave të interesit në nivelin e

investimeve



Zhvendosja e kurbës së kërkesës agregate me nivelin e pandryshuar të çmimeve



Kërkesa agregate sipas modelit Kejnsian


- ▶ Në kërkesën efektive Kejnsi analizon dy sektorë të ekonomisë, atë të amvisërive dhe të bizneseve (**AD = C + I**). Sipas **Kejnsit**, në recesion masat shtetërore duhet të nxisin konsumin personal dhe të stimulojnë investimet.
- ▶ Sipas klasikëve ekuilibrat ekonomikë arrihen me mekanizmat e tregut dhe pozitat e tilla rezultojnë me punësime të plota.
- ▶ Klasikët vlerësonin se kurba e ofertës agregate në kushtet e fleksibilitetit të plot të çmimeve dhe mëditjeve të punëtorëve është në pozitë vertikale dhe ajo tregon se ekonomia punon në nivelet e PBB potencial dhe shfrytëzimit maksimal të resurseve disponuese,
- ▶ Kejnsi vlerëson se çmimet dhe mëditjet në periudha afatshkurta janë jo fleksibile dhe për këtë arsye kurba e ofertës nuk është vertikale, por me pjerrtësi rritëse.



Grafiku 4

Rëndësia e kurbës së kërkesës sipas modelit

Kejnsian



OFERTA AGREGATE (AS - AGGREGATE SUPPLY)

- ▶ Sasi të përgjithshme të ofertave individuale, në një ekonomi kombëtare përbëjnë ofertën agregate, ajo prezanton potencialin prodhues të një ekonomie.
- ▶ Nëse oferta varet vetëm nga niveli mesatar i çmimit (inflacionit) lidhjet e tij me PBB paraqitet vetëm në një kurbë dhe nëse oferta agregate nxitet dhe nga faktorët të tjerë, atëherë kurba e saj zhvendoset majtas (rënie) ose djathtas (rritje) pozicionit të saj fillestar.



Grafiku 5


Kurba e ofertës agregate në periudhën afatshkurtër



Vazhdim...

- ▶ U cek më sipër se kurba e ofertës agregate në periudha afatshkurta kohore ka pjerrtësi rritëse, e cila në fillim është gati e sheshtë dhe vazhdon me pjerrtësi të theksuar, që në fund të bëhet gati vertikale.
- ▶ P.sh. pjerrtësia rritëse e saj dallon dukshëm nga pika e parë A (gati horizontale) e grafikut 5, deri te pika e fundit E (gati vertikale). Për të shpjeguar tendencën e tillë të kurbës së ofertës, dhe për të prezantuar pozitat e ekonomisë kombëtare fillojmë me vështrimin e pikave C, D dhe E të grafikut 5. Pikat të cilat tregojnë rritje proporcionale të çmimeve (10, 20, 30, 40 respektivisht 50 \$) dhe rritje joproporcionale të PBBB (20 miliard \$, 50 miliard \$, 60 miliard \$, 65 miliard \$ respektivisht 67 miliard \$) paraqesin fazat kur ekonomia kalon nga periudha afatshkurtër në periudhë afatgjatë kohore.

Kurba e ofertës agregate në periudha afatgjata kohore (LAS, long aggregate supply)




Oferta agregate – modeli klasik

- ▶ Disekuilibrat ekonomikë mund të jenë vetëm të periudhave afatshkurta, dhe rritja e kërkesës agregate rezulton vetëm me rritjen e nivelit mesatar të çmimeve dhe anasjelltas.
 - ▶ ***Sipas klasikëve ekonomia në periudha afatgjata kohore punon në nivelin e potencialit prodhues dhe punëdhënies së plotë, kurba e saj ka pozitë vertikale ashtu si në grafikun e mëposhtëm.***
-



Oferta agregate sipas modelit Klasik




Faktoret qe mund te ndikojne ne oferten agregate afatshkurte:

- ▶ Paga te fikesuara
- ▶ Çmime te fikesuara
- ▶ Keqperceptimet

- ▶ Faktoret qe mund te ndikojne ne oferten agregate afatgjate:
- ▶ Zhvendosja e shkaktuar nga krahu i punes
- ▶ Zhvendosja e shkaktuar nga kapitali
- ▶ Zhvendosja e shkaktuar nga burimet natyrore
- ▶ Zhvendosja e shkaktuar nga njohuria teknologjike



Rritja e potencialit prodhues (PBB potencial) në një ekonomi kombëtare



EKUILIBRI MAKROEKONOMIK

- ▶ Ekuilibri i ekonomisë kombëtare është objektiv i politikave makroekonomike. Siç e dimë ai arrihet në pikën ku pritet kurba e kërkesës agregate (AD) me kurbën e ofertës agregate (AS).
- ▶ Me fjalë të tjera, në ekuilibrin makroekonomik, blerësit në një ekonomi kombëtare e kërkojnë po atë sasi të të mirave dhe shërbimeve që shitësit (firmat e biznesit), janë të gatshëm ta ofrojnë.
- ▶ Në grafikun 9 ekuilibri i ekonomisë kombëtare është arritur në nivelin PBB-së prej 30 miliard \$ dhe nivelin mesatar të çmimeve prej 120 \$.



.....


- ▶ A paraqesin çështje të rëndësishme ekonomike jo /ekuibrat makroekonomikë afatshkurtë dhe afatgjatë dhe pse?
- ▶ Përse u kushtohet aq shumë rëndësi atyre?
- ▶ Cilët janë efektet ekonomike?...



Grafiku 9

Ekulibri makroekonomik në periudhën


afatshkurtër



Grafiku 10

Kurba e ofertës agregate në periudha afatshkurtër dhe afatgjatë

afatgjatatë kohore



- ▶ Supozojmë se Banka Qendrore me rritjen e ofertës monetare ka nxit kërkesën agregate. Politika ekspansioniste monetare (normat e ulëta të interesit) kanë rrit kërkesën agregate, afatshkurtër duke e zhvendosur kurbën e saj djathtas pozicionit fillestar nga SAD0 në SADI. Pika e re ekuilibruese EI (vendi ku pritet SADI dhe SASI) paraqet ekuilibrin makroekonomik afatshkurtër.
- ▶ ***Në këtë pozitë ekuilibruese PBB real (50 miliard \$) tejkalon atë potencial (40 miliard \$) dhe rritja e tillë ekonomike, siç mund ta vërejmë nga grafiku, përcillet edhe me rritjen e nivelit të çmimeve, nga 100 në 120\$.***



Ndikimi i kërkesës agregate në ekuilibrat ekonomike


A

AD ↑ **AS** konstant = **Niveli i çmimeve** ↑

Niveli mesatar
i çmimeve (në \$)

120

100



40

50

PBB real
(në miliard
\$)


B

AD ↓ **AS** konstant = **Niveli i çmimeve** ↓

Niveli mesatar
i çmimeve (në \$)

120

100



40

50

PBB real
(në miliard
\$)


DISEKUILIBRAT TË CILAT VIJNË NGA GODITJET E OFERTËS

- ▶ Përveç goditjeve të kërkesës agregate, ekuilibrat makroekonomike mund t'i zhvendosë dhe goditja nga ana e ofertës. Rritja e ofertës me kërkesë agregate të pandryshuar krijon pozita më të ulëta ekuilibruese dhe rezulton me rritje ekonomike dhe uljen e nivelit mesatar të çmimeve dhe anasjelltas.
 - ▶ Siç mund të vërehet nga paneli B i grafikut në vijim, oferta agregate e zvogëluar, rezulton reduktimin e PBB-së nga 50 në 40 miliard \$ dhe rritjen e nivelit mesatar të çmimeve nga 100 në 120 \$. ***Rënia ose stagnimi i ekonomisë i përcjellë me rritjen e nivelit mesatar të çmimeve (inflacion) njihet me emrin stagflacion.***
-




Ndryshimet e ekuilibrave ekonomike nga goditjet e ofertës


A



B



Kurthi I Likuiditetit:



III MATJA E AKTIVITETIT EKONOMIK


- ▶ Rrjedhat ekonomike i interesojnë secilit sepse nga ato varet **standardi jetësor** (shtetet që reazon rritje ne periudhe fatgjate arrine standart të lartë jetese (fq.152),**pse?** Nje rritje prej $5\%=14$ vite, sipas rregullit $70/5=14$). Objektiv hulumtimi I makroekonomisë janë të gjitha faktorët , të cilët mund **të rrisin** ose **tkurrin** ekonominë.
 - ▶ **Të ardhurat kombëtare** janë një indikator relevant për matjen e mirëqenies ekonomike dhe sociale të popullsisë. Ato së bashku me konsumin paraqesin faktorët kryesor të cilët nxisin zhvillimin ekonomik.
 - ▶ ***Të ardhurat kombëtare paraqesin të ardhurat e përgjithshme individuale dhe shpenzimet kombëtare paraqesin shumën e të gjitha shpenzimeve individuale.***
-



Grafiku 13

Veprimi interaktiv i amvisërive dhe bizneseve (skema e qarkullimit)



e qarkullimit)



- ▶ Ne një ekonomi kombëtare të ardhurat duhet të jenë të barabarta me shpenzimet apo jo?
-

- ▶ Një minute për te menduar?

- ▶ Skema e qarkullimit, tregon që PBB i një vendi mund të llogaritet si:

- Shpenzim ose e  mirëpo që te dyja sjellin
- Ardhur e përgjithshme  rritjen e PBB,

Niveli i PBB do të raportohet si i njëjtë pa marrë parasysh mënyrën e matjes së tij.



Kuptimi i Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB)

▶ PBB- BPV- GDP

Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB), paraqet indikatorin më të rëndësishëm makroekonomik, i cili mat aktivitetin e përgjithshëm të një vendi.

Ai është treguesi më relevant i potencialit prodhues të një ekonomie kombëtare. Pse?

- ▶ Nga vete fakti që: ***Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB), paraqet të mirat dhe shërbimet e përgjithshme të shprehura në formë monetare, të prodhuara në një ekonomi kombëtare në periudhë një vjeçare.***
 - ▶ ***Shtrohet pyetja cilët janë karakteristikat e PBB që e dallojnë atë nga kategorit tjera makroekonomike?***
-



Karakteristikat e PBB

- ▶ Është gjithëpërfshirës
- ▶ Prezanton të mirat dhe shërbimet finale të shprehura në para sipas vlerës së tregut.
- ▶ PBB paraqet vlerën përfundimtare të të mirave dhe shërbimeve, por jo dhe vlerën e ndërmjetme.
- ▶ PBB mat vlerën e të mirave dhe shërbimeve për periudhën njëvjeçare
- ▶ PBB prezanton vetëm të mirat dhe shërbimet e përgjithshme të realizuara në mënyrë legale
- ▶ PBB nuk përfshin vlerën e të mirave dhe shërbimeve të anëtarëve të familjes.



firmë tekstile

Faazat e prodhimit

Faza I	Prodhimi i pambukut	Fermeri
Faza e II	Përpunimi i pambukut	Firma e përpunimit
Faza e III	Qepja e këmishave	Fabrika tekstile
Faza e IV	Shitja me shumicë	Firma e shitjes me shumicë
Faza e V	Shitja me pakicë	Firma e shitjes me pakicë

Fazat e prodhimit, shitjes dhe vlera e shtuar

	Vlera e shitur e mater. dhe prodhimit	Prodh final (Vlera e shtuar) (Këmisha)	
Fermeri	10	10	(10 – 0)
Firma e përpun. të pambukut	13	3	(13 – 10)
Firma e shitjes me shumicë	17	4	(17 – 13)
Firma e shitjes me pakicë	22	5	(22 – 17)
Vlera totale nga shitja e këmishave	62		--
Vlera e shtuar	-	22	(62 – 40)

Mënyrat e matjes së PBB-së

▶ Vlera e PBB-së mund të matet në 2 mënyra, ato janë:

- a) **Mënyra e shpenzimeve**
- b) **Mënyrën e të ardhurave**

(Të ardhurat kombëtare = mëditjet + renta + kapitali + profiti)

- a) **Mënyrën e prodhimit**



Matja e PBB-së në ekonomin amerikane me metodën e shpenzimeve në vitin 2010, tremujori II

	Sshpenzimet kombëtare	(në miliard \$)	Pjesm. relative (në %)
<i>C</i>	<i>Konsumi familjar</i>	<i>10.362.4</i>	<i>71.0</i>
	Të mirat e konsumit afatgj.	1.072,8	
	Të mirat e konsumit afatshk.	2.333,8	
	Shërbimet	6.955,8	
<i>I</i>	<i>Investimet Bruto</i>	<i>1.763,8</i>	<i>12.1</i>
	Jorezidente	1.371,4	
	Rezidente	355.5	
	Ndryshimet e inventareve	36.9	
<i>G</i>	<i>Shpenzimet qeveritare</i>	<i>2.974.7</i>	<i>20.2</i>
	Shpenzimet federale	1.186,3	
	Shpenz. shtetore dhe lokale	1.788,4	
<i>Nx</i>	<i>Eksporti neto</i>	<i>- 499.4</i>	<i>- 3.3</i>
	Eksporti	1.729,3	
	Importi	2.228,7	
PBB	Prodh. Brendshëm Bruto	14.601,4	100.0

Matja e PBB-së në ekonomin e R. e Sërbisë ndër vite, me metodën e shpenzimeve (në 000.000 denar)

Indikator	Vrsta podatka	Period	Kategorija upotrebe BDP	Bruto domaći proizvod	Izdaci za finalnu potrošnju	Izdaci za ličnu potrošnju - ukupno	Izdaci za ličnu potrošnju - sektor domaćinstava	Izdaci za ličnu potrošnju - sektor NPID	Izdaci za ličnu potrošnju - sektor države	Izdaci za kolektivnu potrošnju	Bruto investicije u osnovna sredstva	Promene u zalihama
Bruto domaći proizvod prema rashodnom pristupu, tekuće i stalne cene	Vrednost, tekuće cene, mil.RSD	2015		4312038.1 ^(t)	3812550.5 ^(t)	3493279.6 ^(t)	3051995.4 ^(t)	52637.4 ^(t)	388646.8 ^(t)	319270.9 ^(t)	723026.0 ^(t)	77489.2 ^(t)
		2016		4521264.7 ^(t)	3929025.3 ^(t)	3611271.4 ^(t)	3152469.6 ^(t)	54617.8 ^(t)	404184.1 ^(t)	317753.9 ^(t)	766310.0 ^(t)	43366.4 ^(t)
		2017		4754368.4 ^(t)	4136270.7 ^(t)	3796274.0 ^(t)	3310993.3 ^(t)	56480.9 ^(t)	428799.8 ^(t)	339996.7 ^(t)	843694.8 ^(t)	87771.9 ^(t)
	Učešće u BDP, %	2015		100.0 ^(t)	88.4 ^(t)	81.0 ^(t)	70.8 ^(t)	1.2 ^(t)	9.0 ^(t)	7.4 ^(t)	16.8 ^(t)	1.8 ^(t)
		2016		100.0 ^(t)	86.9 ^(t)	79.9 ^(t)	69.7 ^(t)	1.2 ^(t)	8.9 ^(t)	7.0 ^(t)	16.9 ^(t)	1.0 ^(t)
		2017		100.0 ^(t)	87.0 ^(t)	79.8 ^(t)	69.6 ^(t)	1.2 ^(t)	9.0 ^(t)	7.2 ^(t)	17.7 ^(t)	1.8 ^(t)
	Vrednost, stalne cene (cene prethodne godine), mil.RSD	2015		4234453.2 ^(t)	3770722.0 ^(t)	3440654.5 ^(t)	2995944.0 ^(t)	51680.2 ^(t)	393030.3 ^(t)	330067.5 ^(t)	695892.7 ^(t)	21413.9 ^(t)
		2016		4456074.5 ^(t)	3860140.2 ^(t)	3541691.0 ^(t)	3090894.9 ^(t)	52573.0 ^(t)	398223.1 ^(t)	318449.2 ^(t)	762125.0 ^(t)	53177.3 ^(t)
		2017		4613919.2 ^(t)	4014733.7 ^(t)	3688306.1 ^(t)	3213943.6 ^(t)	55191.2 ^(t)	419171.2 ^(t)	326427.6 ^(t)	822581.1 ^(t)	82921.2 ^(t)
	Vrednost, ulančane mere obima, referentna 2010.	2015		3394830.2 ^(t)	2998170.8 ^(t)	2731077.2 ^(t)	2354886.9 ^(t)	38939.3 ^(t)	335856.5 ^(t)	267313.2 ^(t)	610707.8 ^(t)	-
		2016		3508228.8 ^(t)	3035595.1 ^(t)	2768925.6 ^(t)	2384901.3 ^(t)	38891.6 ^(t)	344132.0 ^(t)	266625.2 ^(t)	643733.0 ^(t)	-

Tabela 8. PBB i ekonomisë Amerikane Vitit 2003, i logaritur sipas metodës së të ardhurave

Burimi i të ardhurave	Vlera (në miliard \$)	Pjesm. relative (në %)
Mëditjet (kompenz. nga puna)	6.289,00	-
Të ardhurat e pronarëve nga inventari dhe kapiatli	834,00	-
Të ardhurat rentiere	153,80	-
Të ardh. nga huazimi i kapit.	1.021,10	-
Interesi neto nga pagesat e ndr.	543,00	-
Tatimi në prodhim dhe importe	798,10	-
Subvencionet	- 46,70	-
Transferimi i pagesave aktuale të biznesit (neto)	77,70	
Teprica aktuale e firm. Qeveri.	9,50	-
<i>Të ardhurat kombëtare (NP)</i>	<i>9.679,60</i>	<i>87.8</i>
Mospërputhjet statistikore	25,60	-
<i>Të ardh. kombëtare Neto (NNP)</i>	<i>9.705,20</i>	<i>88.2</i>
Konsumi i kapitalit fizik	1.353,90	-
<i>Prodhimi Komb. Bruto (GNP)</i>	<i>11.059,10</i>	<i>- 100.3</i>
Prurjet, të ardhurat nga pjesa tjetër e botës	273,90	
Derdhjet, pagesat ndaj pjesës tjetër të botës	- 329,00	
Prodhimi Brendshëm Bruto (PBB)	11.004,00	100.0

PRODHIMI KOMBËTAR BRUTO (GNP) DHE PRODHIMI KOMBËTAR NETO (NNP)

- ▶ **Prodhimi Kombëtar Bruto (GNP) është i barabartë me Shpenzimet Kombëtare Bruto plus Të Ardhurat Kombëtare Bruto.**
 - ▶ **Prodhimi Kombëtar Neto (NNP) është i barabartë me Shpenzimet Kombëtare Neto plus Të Ardhurat Kombëtare Neto.**
 - ▶ ***Prodhimi Kombëtar Neto (NNP) = Prodhimin Kombëtar Bruto (GNP) – Amortizimi.***
 - ▶ ***Shuma e amortizimit të kapitalit me investimet neto përbëjnë investimet bruto.***
-



GDP DHE GNP (PRODHIMI KOMBËTAR BRUTO)

- ▶ **GDP** është kategori më e përgjithshme se sa (**GNP**), sepse ai përfshin dhe neto pagesat me ekonomitë e tjera.
- ▶ **P.sh Firmat nga R.Sërbisë qe operonë ne vendet tjera!**
- ▶ **Sa me e lartë të jete GNP nga GDP** ekonomia është në pozitë më të mirë, sepse fitimet neto nga jashtë janë me të mëdha se të dalat.



PBB NOMINAL DHE REAL (DEFLATORI)

- ▶ PBB mund të shënon rritje në 2 mënyra: **e para** me zgjerimin e aktiviteteve prodhuese, me stagnimin ose rënie ekonomike, **e dyta** me rritjen e nivelit mesatar të çmimeve (inflacionit).
- ▶ Në rastin e I-rë bëhet fjalë për **PBB real**, i cili prezanton potencialin prodhues të një ekonomie kombëtare, ku të mirat dhe shërbimet finale llogariten sipas çmimeve të një viti bazë, që nënkupton eliminimin e inflacionit.
- ▶ Në rastin e II-të bëhet fjalë për **PBB nominal**, i cili llogaritet sipas çmimeve korente ose vijuese, në të cilat përfshihet dhe inflacioni.

Vërejtje:

- ▶ Çdo herë **PBB nominal me PBB real në vitin bazë janë të barabartë.**
- ▶ **Deflatorit tregon rritjen e nivelit mesatar të çmimeve (inflacionit)**

Deflatorët e disa shteteve selektive për vitet 2010, 2011, 2012 dhe 2013 (në %)

	2010	2011	2012	2013
Belgjika	2.0	2.2	2.1	1.5
Norvegjia	6.3	6.7	2.8	2.9
Slloveni	- 1.1	1.2	0.3	1.4
Kroacai	0.8	1.7	1.8	0.8
Britania e Madhe	3.2	2.3	1.8	1.5
Zvicra	0.3	0.2	- 0.1	- 0.2
franca	1.1	0.9	1.2	0.8
Luksemburgu	3.7	5.0	3.5	1.3
Japonia	- 2.2	- 1.9	- 0.9	- 0.5
SHBA	1.2	2.1	1.8	1.5
Shqipëria	4.5	2.3	1.0	0.8
Mali Zi	1.6	0.9	- 0.1	2.2
Bullgaria	1.2	7.0	1.6	- 0.8

PBB REAL DHE POTENCIAL

- ▶ *PPB potenciali prezanton tendencat afatgjata të prodhimeve dhe shërbimeve në një ekonomi.*
- ▶ *Me fjalë të tjera PBB potencial, prezanton normën mesatare të rritjes së PBB aktuale në periudha afatgjata kohore.*
- ▶ **Funksionimi i ekonomisë në nivelin e PBB potencial, nënkupton shfrytëzimin racional të resurseve disponuese.**
- ▶ **Në PBB potencial ekonomia punon me një punëzënie të plotë (norma natyrore të papunësisë).**
- ▶ ***Në fazën e ekspansionit ekonomik, PBB real është mbi PBB potencial dhe ekonomia mund të kalojë në inflacione të pakontrolluara, përkundrazi, kur PBB real ndodhet nën nivelin e PBB potencial ekonomia ndodhet në recesion i cili me kalimin e kohës thellohet më tej dhe kalon në depresion.***

IV RRIJTJA EKONOMIKE

- Shtete e ndryshme realizojë norma te ndryshme te zhvillimit. Ne saje te politikave efikase makroekonomike disa shtete (sic jane shtetet aziatike, Singapori, Korea e Jugut, Tajvani...) kaluan nga vendet me ekonomi të pazhvilluara në vende të pasura të botës (duke dyfishuar të ardhurat çdo 10 vite)
 - Andaj kreatorët e politikave ekonomike para vetës shtronë pyetjet?
 - a) Si të arrihen norma të larta të PBB-së?
 - b) Cilat politika makroekonomike duhet zbatuar?
 - c) A janë të sigurta shtetet e zhvilluara se rritja e tyre do të vazhdojë edhe në të ardhmen?
 - d) Çfarë u mungon shteteve jo mjaft të zhvilluara, për rritje afatgjatë?
-



KUPTIMI I RRITJES EKONOMIKE

- ▶ PBB real dallohet nga PBB potencial, sepse i pari tregon ndryshimet e të mirave dhe shërbimeve nga viti në vit (periudha afatshkurtra) dhe i dyti tregon tendencat afatgjate.
- ▶ ***Rritja ekonomike tregon rritjen e PBB real të vitit të fundit krahasuar me vitin paraprak shprehur në %, dhe në mënyrë matematikore mund ta prezantojmë si më poshtë:***

$$G = \frac{PBB (t) - PBB (t-1)}{PBB (t - 1)} \times 100$$



- ▶ **Të mirat dhe shërbimet të shprehura me çmimet e tregut (PBB) pjesëtuar me numrin e popullsisë quhet PBB për frymë banori ose për capita.**
-

- ▶ Ky tregues në mënyrë më besnike prezanton jo vetëm zhvillimin ekonomik të një vendi, por nivelin e standardit jetësor të popullsisë.

- ▶ Çka praktikisht përfaqëson ky tregues?

- ▶ Shih.tab.ne vijim!

- ▶ Ekonomistëve u intereson pse ndodhin këto ndryshime?

- ▶ Kush i përcakton ato?

- ▶ Cilat politika ekonomike duhet të zbatohen për të qenë efikas në rritje?



Faktorët e rritjes ekonomike

- faktorët e natyrës ekonomike dhe jo ekonomike
 - Siç e dimë nga **mikroekonomia**, puna, toka, kapitali dhe sipërmarrësia ishin faktorë kryesorë të cilët determinonin sasinë e prodhimit dhe shërbimeve.
 - Nëse ekonomia shfrytëzon maksimalisht këto resurse ajo punon në nivelin e prodhimit potencial (PBB potencial). **Apo jo?**
 - Vlerësoj se me rëndësi është prezantimi i faktorëve, si p.sh., sistemet ekonomike, veprimet e politikave shtetërore, menaxhimi me zhvillimin, arsimi, punët shkencore hulumtuese, shëndetësia, sigurimet sociale, etj.
 - Veprimet e politikave ekonomike poashtu mund ta frenojnë ose ta nxisin rritjen ekonomike në një shtet.
-



- ▶ Çka nënkuptojmë me funksion te prodhimit në mikroekonomi?
 - ▶ E njëjta vlen e dhe ne Makroekonomi!
-

$$Y = AF (K, L)$$

A – është variabël e cila tregon teknologjinë disponuese.

Nëse teknologjia përmirësohet, variabla A rritet dhe ekonomia prodhon më shumë të mira dhe shërbime dhe anasjelltas.

F - tregon kombinimet e inputeve.

K – kapitalin disponues dhe

L – punën.

- ▶ $\Delta Y/Y = \{ (1 - \theta) \times \Delta N/N \} + (\theta \times \Delta K/K) + \Delta A/A \}$
 - ▶ *Rritja e prodhimit = {pjesa e punës x rritja e punës} + {pjesa e kapitalit x rritja e kapitalit} + përparimi teknik}*
-



ROLI I PRODUKTIVITETIT TË PUNËS NË RRITJEN EKONOMIKE

- **Produktivitetin e punës** kuptojmë sasinë e të mirave dhe shërbimeve të cilat një punëtor mund t'i prodhojë për kohë të caktuar, e cila zakonisht matet me orë.
 - ***Si mund ta përllogarisim produktivitetin e ekonomise kombëtare?***
 - ***Produktiviteti në ekonominë kombëtare fitohet duke pjesëtuar PBB për numrin e të punësuarve!***
 - Shtrohet pyetja cilët faktorë determinojnë (përcaktojnë) produktivitetin?
 - ***Kapitali fizik***
 - ***Kapitali human***
 - ***Resurset natyrore***
 - ***Avancimet teknologjike***
-



Faktorët me të cilat mund të menaxhojë qeveria për rritjen ekonomike janë :

- ▶ **Kursimi dhe investimet**
 - ▶ **Rritja e sasive të kapitalit** (Ekonomitë e zhvilluara rriten me norma të ulëta zhvillimore, përkundrazi, ekonomitë jo mjaft të zhvilluara me norma të larta të rritjes) **Pse? Nje minutë për të menduar!...** Ligji rënës i prodhimit marxhinal
 - ▶ **Investimet e huaja**
 - ▶ **Arsimi**
 - ▶ **Hulumtimet**
 - ▶ **Ekonomia e hapur**
 - ▶ **Infrastruktura**
 - ▶ **Stabiliteti politik dhe sigurimi i kapitalit**
 - ▶ **Rritja e popullsisë (Thomas Mlthusit-1766 deri 1834)**
-

